

TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 2/133
Dt. 30.12.2016
Fushë Kosovë - Fushë Kosovë - Kosovo Polje



trainkos

2017

RREGULLORE MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR
KONTRATË DHE KUSHTET E TRANSPORTIT TË MALLRAVE





**RREGULLORE MBI PERCAKTIMIN E KRITEREVE
PER KONTRATË DHE KUSHTET E TRANSPORTIT
TE MALLRAVE**

**FUSHË KOSOVË
Dhjetor 2016**

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| 1. Dispozitat | |
| hyrëse..... | 3 |
| 2. Kontraktimi..... | 3 |
| 3. Kushtet e Transportit..... | 4 |
| 3.1. Llojet e Transportit..... | 4 |
| 3.2. Trainkos Sh.A ofron transporte | 4 |
| 3.3. Lloji i dërgesave..... | 5 |
| 3.4. Modelet e Transportit. | 5 |
| 4. Kalkulimi i çmimeve të Transportit..... | 5 |
| 4.1. Dërgesat me vagon për Transportin e rëndomtë..... | 6 |
| 4.2. Transporti i dërgesave vagonore sipas marrëveshjes..... | 8 |
| 4.3. Transporti ushtarak..... | 8 |
| 4.4. Transporti i dërgesave vagonore me tren marshut..... | 9 |
| 4.5. Dërgesat të cilat transportohen me vagon (privat) ose vagon të marr me qera..... | 9 |
| 4.6. Transporti i kontejnerëve..... | 10 |
| 4.7. Treni marshut me kontejner..... | 10 |
| 4.8. Transporti i dërgesave të veçanta..... | 12 |
| 5. Kalkulimi- llogaritja e RIV-it..... | 13 |
| 6. Pagesat shtesë..... | 15 |
| 6.1. Pagesat shtesë për matjen e vagonëve..... | 15 |
| 7. Beneficionet Tarifore..... | 16 |
| 7.1. Tabela tarifore e beneficioneve për klientët me deklaram të sasisë së transportit..... | 16 |
| 7.2. Tabela tarifore e beneficioneve për klientët e rëndomtë..... | 17 |
| 8. Zbritja e çmimeve tarifore..... | 17 |
| 9. Kufizimet..... | 17 |
| 10. Pagesat e borxheve..... | 18 |
| 11. Dispozita përfundimtare..... | 18 |
| 12. Shkurtesat | 21 |
| 13. Telemtri për Transportin e mallrave në Trainkos Sh.A..... | 22 |

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit 03/L087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP . Bordi i Drejtorëve i HK TRAINKOS SH.A në Mbledhjen Nr.18 të mbajtur më 30.12.2016 miratoi këtë :

RREGULLORE

Mbi përcaktimin e kriterëve për kontratat, kushtet e transportit dhe zbatimin e pagesave nga realizimi i transportit deri në hartimin dhe aprovimin e tarifave ndërkombëtare të Trainkos Sh.A.

Neni 1

Dispozitat hyrëse

Me këtë Rregullore definohet dhe caktohet mënyra e kontraktimit të transportit të mallrave , kushtet e transportit , kalkulimi dhe pagesa e çmimit për transportin e realizuar, pagesat sipas RIV-it dhe beneficionet .

Neni 2

Kontraktimi

Të drejtën për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit të mallrave përmes Trainkos Sh.A. e ka çdo subjekt afarist , juridik , fizik vendor dhe ndërkombëtar, nëse shpreh vullnetin për lidhjen e kontratës për transportimin e mallrave të cilat kanë mundësi të transportohen përmes Trainkos Sh.A. nëse transporti i atyre mallrave nuk është i ndaluar me ndonjë ligj ose ndonjë ndalesë të përkohshme administrative.

Trainkos Sh.A do të aplikoj procedura për shprehje interesi për partneret të ri.

Kontraktimi i transportit të mallrave mund të realizohet :

1. Duke e shprehur vullnetin për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit të mallrave përmes ushtrimit të kërkesës së shkruar dhe të adresuar në Trainkos Sh.A. përmes Nr të tel: +381 (0) 38 534 837 përmes E-mail marketing@trainkos.com . Sektori i Marketingut obligohet që ofertën e transportit vendore ta dërgoj drejt klientit brenda 24 orëve prej momentit të pranimit të kërkesës, ndërsa ofertën e transportit për transportin ndërkombëtar afati për dërgimin e ofertes së transportit nga sektori i marketingut është 2 deri në 5 ditë pune pas pranimit të kërkesës nga klienti. Nëse Trainkos Sh.A ka mundësi transportuese, pas plotësimit dhe aprovimit të kërkesës , klienti ose subjekti afarist e plotëson fletë ngarkesën dhe pas kryerjes së formaliteteve të caktuara , në momentin e marrjes dhe vulosjes së fletë ngarkesës konsiderohet se është lidhur kontrata për transportin e mallrave me hekurudhë.

Kjo kontratë vlen vetëm për sasinë dhe llojin e mallrave të shënuara në fletë ngarkesë.

2. Me kontratë të veçantë (marrëveshje), definohet sasia vjetore e transportit, lloji i mallrave, lloji i klientit (klientë me deklaram paraprak dhe klientë i rendomt) mënyra e pagesës për transportin e realizuar, kushtet e veçanta të transportit , beneficionet dhe zbritjet eventuale .

Kontratë të veçantë me Trainkos Sh.A, mund të lidhë çdo subjekt afarist juridik ose fizik, vendor dhe ndërkombëtar, nëse paraprakisht parashtron kërkesë më shkrim dhe pranon kushtet e kësaj rregullore.

Kontratën për transportin e mallrave e negoncion dhe e përpilon Sektori i Marketingut , e kontrollon dhe verifikon përgjegjësi i parë Drejtori i Departamentit te Zhvillimit te Bizneseve, e verifikon Drejtori i Departamentit te Operimeve , e verifikon Drejtori i Departamentit te Financave , e verifikon Drejtori i Departamentit te Administratës, e verifikon Shefi i Zyrës se Kontrollit , Sigurisë dhe Kualitetit dhe e njëjta kontrate aprovohet dhe nënshkruhet nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Në bazë të kontratës për transportin e mallrave transportuesi Trainkos Sh.A obligohet që transportoj mallrat në gjendje të pa ndryshueshme deri në stacionin pritës ndërsa shfrytëzuesi i transportit është i obliguar që çmimet e transportit ti paguaj sipas kontratës për transportin e realizuar (të kalkuluar në fletë ngarkesë).

Kompanitë ndërkombëtare, janë të obliguara që para nënshkrimit të marrëveshjes për transport me Trainkos Sh.A duhet të sigurojnë garancionin bankar prej 5 % (të hyrave në Euro) të vlerës totale të kontratës së transportit.

Kalkulimi i garancionit bankar behet ne baze te deklarimit te sasisë nga klientët/partneret për vitin ne vijim duke e marre për baze mesataren e çmimit te transportit nga viti paraprak.

Vlera minimale e garancionit bankar nuk mund të jetë më e vogël se 1,000.00 € pavarësisht vlerës së deklaruar në kontratë.

Trainkos Sh.A e gëzon të drejtën e plotë për vazhdimin ose mos vazhdimin e kontratës me klientët të cilët i kanë borxh Trainkos-it.

Neni 3 Kushtet e transportit

Me kushte të transportit nënkuptojmë mënyrën e transportit , llojin e transportit , llojin e dërgesave dhe mënyrën e transportimit.

3.1 Llojet e transportit:

- Transporti hekurudhor; dhe
- Transporti i kombinuar (me kamionë).

Me transport të kombinuar nënkuptojmë transportin direkt të mallrave prej stacionit të nisjes deri në stacionin e fundit pritës , duke i përdorur dy lloje të transportit (transportin hekurudhor dhe rrugor).

3.2 Trainkos Sh.a ofron transportet si më poshtë:

- Transport i vendor; dhe
- Transporti ndërkombëtarë (eksport, import dhe transit).

Me transportin vendor të mallrave nënkuptojmë, transportin e dërgesave me vagonë brenda territorit të Kosovës , me fletë ngarkesën vendore K-501.

Me transportin e mallrave ndërkombëtare nënkuptojmë, transportin e dërgesave nga Kosova për ndonjë shtet tjetër, nga shtetet tjera për në Kosovë dhe prej shteteve tjera transit nëpër Kosovë

për ndonjë shtet tjetër. Ky lloj transporti për dërgesat me vagonë kryhet sipas dispozitave të CIT-it më fletë ngarkesën CIM.

Deri në zbatimin e dispozitave të rregullave të CIT-it në Trainkos Sh.A, stacionet kufitare Hani i Elezit dhe Leshak, në bazë të fletë ngarkesës CIM (fotokopja), e cila e përcjell dërgesën, duhet më plotësuar fletë ngarkesën vendore K-501, të cilës i bashkëngjitet fotokopja e CIM-it, me shtojcat tjera të cilat dërgesën e shoqërojnë deri në stacionin e pritjes për mallrat e importuara , në të cilën kalkuloohen çmimet e transportit për Trainkos-in, ndërsa për eksport nga fletë ngarkesa vendor K-501 në fletë ngarkesën CIM.

3.3 Lloji i dërgesave:

Dërgesë nënkuptohet një ose më shumë lloje të mallrave të cilat dorëzohen për transport me një fletë ngarkesë.

Dërgesa sipas llojit mund të jetë dërgesë me një vagon ose me grup vagonë .

Dërgesë vagoni konsiderohet nëse dërguesi kërkon përdorimin e vetëm një vagoni për dërgesë, ose në bazë të ligjit dhe dispozitave tjera ku dërgesa detyrimisht duhet të transportohet me vagonë të veçantë apo grup vagonë.

3.4 Modelet e transportit:

- Transport i rëndomtë; dhe
- Transporti sipas kontratës

Me transport të rëndomtë nënkuptojmë transportin e dërgesave pa ndonjë kontrate të veçantë por duke u bazuar në tarifatat aprovuara në këtë rregullore.

Transporti i kontraktuar është transport i dërgesave në mes të Trainkos-it si transportues dhe shfrytëzuesit të transportit, më të cilin caktohen kushtet e veçanta për transport, pagesat beneficionet dhe zbritjet eventuale.

Neni 4

Kalkulimi i çmimeve të transportit

Me termin çmimet e transportit nënkuptojmë çmimin për transport të mallrave, kalkulimet e çmimeve shtesë për shërbime të veçanta dhe çmimet tjera të kalkuluara në fletë ngarkesë.

Çmimet e transportit caktohen sipas:

- Llojit të dërgesës (vagonësh);
- Mënyrës së transportit (i rregullt ose sipas marrëveshjes);
- Llojit të mallit (sipas klasës tarifore);
- Masës së dërgesës (masa llogaritëse);
- Distancës tarifore (telemetrit); dhe
- Llojit dhe pronësisë së vagonit (shtetëror – privat) .

Mallrat të cilat transportohen si dërgesa vagonësh janë të klasifikuara në 2 klasa tarifore, çmimet e transportit kalkuloohen sipas klasifikimit të mallrave nga TEA tarifa (tarifa Evropa-Azia), të cilën në vendin e punës duhet ta kanë punonjësit e shërbimit komercial , sektori i Marketingut si dhe zyra e kontrollit.

Në çdo klasë tarifore ekzistojnë nga 4 qëndrime tarifore, dhe atë: 10 ton, 15 ton , 20 ton dhe 25 ton.

Për kalkulimin e çmimeve zbatohet qëndrimi tarifor i cili i përgjigjët masës së kalkuluar të dërgesës.

Masa për kalkulimin e çmimeve transportuese është:

- a) Për një vagon të përdorur më së paku 5 000 kg për bosht; dhe
- b) për zbatimin e qëndrimit tarifor:
 - 10 ton për më së paku 10 000 kg;
 - 15 ton për më së paku 15 000 kg;
 - 20 ton për më së paku 20 000 kg; dhe
 - 25 ton për më së paku 25 000 kg.

Nëse masa e dërgesës është ndërmjet dy qëndrimeve tarifore, çmimet e transportit kalkuloohen për masën llogaritëse dhe qëndrimin tarifor për:

- 10 ton, qëndrimi tarifor deri në 12 ton;
- 15 ton, qëndrimi tarifor prej 12.1 ton deri në 16.5 ton;
- 20 ton, qëndrimi tarifor prej 16.6 ton deri në 22 ton; dhe
- 25 ton, qëndrimi tarifor prej 22.1 ton e më tepër.

4.1. Dërgesat me vagon në transportin e rëndomtë:

Për dërgesat me vagon, çmimet e transportit kalkuloohen sipas qëndrimeve tarifore të dhëna në tabelat tarifore për komunikacion ndërkombëtar dhe vendor.

Tabela nr. 1

I . TABELA TARIFORE (Import , Eksport dhe Transit) Euro për ton

| KM | Klasa I | | | | Klasa II | | | |
|---------|---------|-------|-------|-------|----------|-------|-------|------|
| | 10 t | 15 t | 20 t | 25 t | 10 t | 15 t | 20 t | 25 t |
| 01-50 | 8.40 | 6.80 | 5.40 | 4.70 | 7.70 | 6.20 | 5.00 | 4.30 |
| 51-60 | 9.50 | 7.60 | 6.10 | 5.30 | 8.70 | 7.00 | 5.50 | 4.90 |
| 61-70 | 10.40 | 8.30 | 6.60 | 5.80 | 9.30 | 7.60 | 6.10 | 5.30 |
| 71-80 | 11.00 | 8.80 | 7.10 | 6.20 | 10.10 | 8.20 | 6.50 | 5.70 |
| 81-90 | 11.50 | 9.30 | 7.40 | 6.50 | 10.50 | 8.60 | 6.80 | 5.80 |
| 91-100 | 11.90 | 9.70 | 7.70 | 6.70 | 10.80 | 8.90 | 7.00 | 6.20 |
| 101-110 | 12.60 | 10.20 | 8.10 | 7.00 | 11.50 | 9.30 | 7.40 | 6.50 |
| 111-120 | 13.20 | 10.70 | 8.50 | 7.40 | 12.10 | 9.80 | 7.80 | 6.80 |
| 121-130 | 13.90 | 11.30 | 9.00 | 7.70 | 12.80 | 10.30 | 8.20 | 7.20 |
| 131-140 | 14.60 | 11.70 | 9.30 | 8.10 | 13.40 | 10.70 | 8.50 | 7.40 |
| 141-150 | 15.10 | 12.10 | 9.60 | 8.40 | 13.90 | 11.20 | 8.80 | 7.70 |
| 151-160 | 15.80 | 12.70 | 10.20 | 8.80 | 14.50 | 11.70 | 9.30 | 8.10 |
| 161-170 | 16.50 | 13.40 | 10.60 | 9.20 | 15.10 | 12.30 | 9.70 | 8.40 |
| 171-180 | 17.20 | 13.80 | 11.00 | 9.60 | 15.80 | 12.70 | 10.10 | 8.70 |
| 181-190 | 17.80 | 14.30 | 11.40 | 9.90 | 16.30 | 13.10 | 10.50 | 9.10 |
| 191-200 | 18.40 | 14.80 | 11.80 | 10.30 | 16.90 | 13.60 | 10.80 | 9.40 |

*Vërejtje: Çmimi më i ulët i çmimeve të transportit për një vagon është 100.00 €
Çmimet e mësipërme për transport të mallrave (Import, Eksport dhe Transit) janë pa TVSH .*

Tabela nr.2

II. TABELA TARIFORE (Për transport vendor) Euro për ton

| KM | Klasa I | | | | Klasa II | | | |
|---------|---------|-------|------|------|----------|------|------|------|
| | 10 t | 15 t | 20 t | 25 t | 10 t | 15 t | 20 t | 25 t |
| 01-50 | 6.53 | 5.25 | 4.15 | 3.56 | 5.59 | 4.45 | 3.02 | 3.77 |
| 51-60 | 6.95 | 5.68 | 4.49 | 3.98 | 6.02 | 4.81 | 3.38 | 4.08 |
| 61-70 | 7.37 | 6.19 | 4.83 | 4.41 | 6.44 | 5.24 | 3.73 | 4.44 |
| 71-80 | 7.80 | 6.69 | 5.17 | 4.75 | 6.86 | 5.67 | 4.02 | 4.81 |
| 81-90 | 8.10 | 7.20 | 5.59 | 5.00 | 7.37 | 6.10 | 4.24 | 5.17 |
| 91-100 | 9.32 | 7.54 | 5.93 | 5.17 | 7.97 | 6.39 | 4.38 | 5.42 |
| 101-110 | 9.66 | 7.88 | 6.27 | 5.42 | 8.39 | 6.68 | 4.60 | 5.66 |
| 111-120 | 10.17 | 8.22 | 6.53 | 5.76 | 8.81 | 6.97 | 4.88 | 5.90 |
| 121-130 | 10.68 | 8.73 | 6.95 | 5.93 | 9.32 | 7.40 | 5.03 | 6.27 |
| 131-140 | 11.19 | 8.98 | 7.20 | 6.27 | 9.75 | 7.61 | 5.31 | 6.45 |
| 141-150 | 11.61 | 9.32 | 7.37 | 6.53 | 10.00 | 7.90 | 5.53 | 6.69 |
| 151-160 | 12.12 | 9.75 | 7.88 | 6.78 | 10.51 | 8.26 | 5.75 | 7.00 |
| 161-170 | 12.63 | 10.34 | 8.14 | 7.12 | 10.93 | 8.76 | 6.03 | 7.43 |
| 171-180 | 13.31 | 10.59 | 8.47 | 7.37 | 11.44 | 8.98 | 6.25 | 7.61 |
| 181-190 | 13.73 | 11.02 | 8.81 | 7.63 | 11.86 | 9.34 | 6.46 | 7.91 |
| 191-200 | 14.24 | 11.36 | 9.07 | 7.97 | 12.29 | 9.62 | 6.75 | 8.16 |

*Vërejtje: Çmimi më i ulët i çmimeve të transportit për një vagon është 100.00 €
Çmimet e mësipërme për transport të mallrave (transport vendor) janë pa TVSH .*

- Partneret/Klientët të cilët e realizojnë transportin e mallrave me Bllok Trena min. 600 ton ofrohet zbritje prej 20 % nga tarifat e rregullta për transport të mallrave (Import, Eksport dhe Transit).
- Partneret/Klientët të cilët e realizojnë transportin e mallrave me Bllok Trena min. 600 ton me vagonë private ``P`` ofrohet zbritje prej 10 % nga tarifat e rregullta për transport të mallrave (Import , Eksport dhe Transit) .

4.2 Transporti i dërgesave vagonore sipas Kontratës

Dërgesat me vagon në transportin e kontraktuar (sipas marrëveshjes), pranoen në transport dhe çmimet e transportit kalkuloen në bazë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet shfrytëzuesit të transportit dhe transportuesit.

Me këtë marrëveshje caktohet çmimi i transportit, kalkulimi i çmimeve shtesë të cilat ndikojnë në rritjen e çmimeve të transportit dhe kushtet e veçanta të cilat i kërkon shfrytëzuesi i transportit për transportin e kontraktuar.

Dërgesat me vagon nga importi, eksporti dhe transiti të cilat transportohen përmes Trainkos-it nuk mund të llogariten si dërgesa të kontraktuara (sipas marrëveshjes), por si dërgesa të rëndomta. Në bazë të marrëveshjeve paraprake në komunikacionin ndërkombëtar mund të zbatohet transporti sipas marrëveshjes. Në këto raste me pëlqimin e hekurudhave të interesuara, marrëveshjen me klientin e lidhë hekurudha në të cilën gjendet stacioni i nisjes së dërgesës.

Për transportet sipas marrëveshjes dhe transportet e zakonshme në Trainkos Sh.A, si subjekt afarist për një dërgesë mund të paraqitet vetëm një klient – pronari i mallit , ose ndonjë subjekt tjetër afarist – shpedicioni i autorizuar i cili në emër të klientit kontakton, kontrakton dhe kryen të gjitha obligimet ndaj Trainkos Sh.A.

4.3. Transporti ushtarak

Transport i përzier ushtarak, konsiderohet transporti i njerëzve dhe mjeteve ushtarake të të gjitha njësive ushtarake, me trena të veçantë i cili paraprakisht duhet të Instradohet nga njësiti ushtarak në Trainkos.

Transportet e përziera ushtarake përcillen me një fletë ngarkesë (si në komunikacionin ndërkombëtar dhe në atë vendor) të cilës i bashkëngjitet fleta shtesë (specifikacioni) në 5 kopje.

Për transporte të përziera ushtarake të cilat në përbërjen e tyre kanë kontejner dhe pajisje të tjera ushtarake çmimet e transportit kalkuloen sipas tabelës tarifore për transport të rëndomta, por e njëjta nuk mund të jetë më e vogël se masa llogaritëse prej 500.000 kg. (500 ton) për klasën e parë tarifore dhe qëndrimin tarifor për 25 – ton.

Për transportet ushtarake të cilat në përbërje të trenit kanë vetëm transport me kontejnerë çmimet e transportit kalkuloen sipas tabelës tarifore për kontejnerë.

Për transporte të përziera ushtarake për grupe të vagonëve dhe të një vagoni për të cilët nuk kërkohet transporti me trena të veçantë, çmimet e transportit kalkuloen sipas tabelës tarifore për transporte të rëndomta, për klasën e parë tarifore dhe masën llogaritëse për më së paku 5.000 kg. (5 ton) për bosht të vagonit të përdorur.

Kërkesat për transportet e veçanta i pranon Menaxheri i Sektorit të Transportit të Mallrave dhe i Marketingut , kërkesa behet nga hekurudha përkatëse të cilat e organizojnë dërgesën e veçante, në baze të kërkesës Menaxheri i Transportit të Mallrave e procedon tutje kërkesën drejt Menaxherit të Mirëmbajtjes së Vijave Hekurudhore në kompaninë Infrakos Sh.A për të marrë pëlqimin dhe kushtet e trajtimit të dërgesës .

Pas marrjes së pëlqimit dhe kushteve të dërgesës nga Menaxheri i Mirëmbajtjes së Vijave Hekurudhore – Infrakos Sh.A , Menaxheri i transportit të mallrave përgatitë formularin **TR ST** (emërtimi standard sipas CIT-it) i cili posedon numrin rendor të dërgesave të veçanta sipas listës për vitin përkatës , kushtet e transportit të aprovuara (se bashku me komentet përkatëse) nga

Menaxheri i Mirëmbajtjes së Vijave Hekurudhore – Infrakos Sh.A, nënshkrimi i formularit dhe i njëjti i dërgohet hekurudhave përkatëse .

Pëlqimi i kushteve të dërgesave të pranuar nga Mirëmbajtja e Vijave Hekurudhore një kopje i dërgohet përmes e-mail Menaxherit/es së Marketingut .

4.4. Transporti i dërgesave vagonore me tren marshut

Transporti i dërgesave me tren marshut , konsiderohet transporti më së paku 500.000 kg. (500 ton) për një lloj malli të ngarkuar në më shumë vagonë për një klient dhe një stacion pritës.

Në bazë të kërkesës së klientit për tren marshut në transportin ndërkombëtare negocohen marrëveshja në mes të hekurudhave pjesëmarrëse për transport dhe pastaj klientit i lejohet transporti me trena marshut .

Treni marshut për transport dorëzohet vetëm me një fletë ngarkesë të cilës i bashkëngjitet fleta shtesë (specifikacioni) i plotësuar në 5 kopje.

Lejen për nisjen e trenave marshut e jep hekurudha përkatëse në të cilën gjendet stacioni i nisjes , numri i lejes shënohet në rubrikën nr. 28 të fletë ngarkesës së CIM-it.

Trenat me dërgesa, masa e të cilave është më madhe se 500.000 kg. (500 ton) pa leje si tren marshut, nuk do të llogariten si tren marshut.

Kalkulimi i çmimeve të transportit për tren marshut bëhet duke e mbledhur masën e mallrave të ngarkuar në të gjithë vagonët, dhe atë:

- a) Nëse mallrat transportohen më vagonë të transportuesit , çmimet e transportit kullohen në bazë të masës llogaritëse, klasës përkatëse tarifore dhe qëndrimin tarifor të dhëna në tabelën tarifore për dërgesa të rëndomta.
- b) Nëse mallrat transportohen më vagonë privat , çmimet e transportit kullohen në bazë të masës llogaritëse , klasës përkatëse dhe qëndrimin përkatës tarifor të dhënë në tabelën tarifore për dërgesa të rëndomta e cila do të zbritet për 20%.

4.5 Dërgesat të cilat transportohen me vagon (privat) ose me vagon të marr me qira.

Vagonët e shfrytëzuesit të transportit konsiderohen vagonët të cilët janë futur në parkun e vagonëve të ndonjë hekurudhe në emër të ndonjë subjekti afarist ose personi juridik.

Vagonët privat identifikohen me shenjën “P” dhe numrin përkatës të vagonëve privat.

Vagonët privat dhe vagonët e marrë me qira mund të ngarkohen me mallra të cilat janë të shënuara në kontratën e transportit për hyrjen e tyre në parkun e vagonëve të ndonjë hekurudhe.

Për transportin e mallrave me këta vagon, çmimet e transportit kullohen:

- a) Për vagonë të ngarkuar në bazë të masës llogaritëse, klasës dhe qëndrimin përkatëse tarifor të dhënë në tabelën tarifore për dërgesa të rëndomta të pa rumbullakuara zbritën për 20%.

- b) Për vagon të zbrazët sipas masës së vagonit (tarës), jo më pak se 10.000 kg për vagon, klasës dhe qëndrimit përkatëse tarifor të dhënë në tabelën tarifore për dërgesa të zakonshme të pa rrumbullakuara zbritën për 70%.
- c) Çmimi më i ulët për një vagon të ngarkuar është **100.00 €**, ndërsa çmimi më i ulët për një vagon të zbrazët është **30.00 €**.

Për vagonë të zbrazët të shfrytëzuesit të transportit (privat) dhe vagonë të marrë me qira për territorin e Kosovës ku vepron Trainkos Sh.A. plotësohet fletë ngarkesa vendore K-501.

4.6 Transporti i kontejnerëve

Transporti i mallrave përmes Trainkos Sh.A realizohet edhe me kontejner.

Varësisht prej gjatësisë kontejnerët ndahen në 4 kategori dhe atë:

- Kategoria 10 – gjatësia 10 shputa (foot) ose 2.990 m - kontejner i vogël;
- Kategoria 20 – gjatësia 20 shputa (foot) ose 6.058 m - kontejner i mesëm;
- Kategoria 30 – gjatësia 30 shputa (foot) ose 9.125 m - kontejner i madh; dhe
- Kategoria 40 – gjatësia 40 shputa (foot) ose 12.192 m - kontejner i madh.

Kontejnerët e plot dhe të zbrazët pranojnë në transport si dërgesa vagonore, me një fletë ngarkesë.

Kushtet për transportin e kontejnerëve e cila është e lidhur me parë në mes të Hekurudhave Maqedone dhe atyre Greke, do të vlejnjë edhe për territorin e Kosovës ku operon Trainkos Sh.A.

Çmimet për vendosjen e vagonit për ngarkim/shkarkim të kontejnerëve në binarin industrial nga/në stacionin e nisjes/pritës, kalkulojnë sipas tabelës tarifore për pagesat shtese të binarit industrial të precizuara në këtë rregullore.

Çmimet për vendosjen e vagonëve me kontejnerë vlejnjë për transport komercial dhe ushtarak.

4.7 Treni marshut me kontejnerë

Me trenin marshut me kontejnerë nënkuptojmë, trenin e përbërë prej më së paku 34 kontejnerëve prej 20 shputave (të plotë dhe të zbrazët).

Me trenin marshut me kontejnerë nënkuptojmë, trenin e përbërë prej më së paku 17 kontejnerëve prej 40 shputave (të plotë dhe të zbrazët).

Treni i cili përbëhet prej kontejnerëve 40 dhe 20 shputave ose vetëm kontejnerëve të 40 shputave. llogariten si 2 (dy) kontejner nga 20 shputa.

Treni marshut me kontejnerë, në rubrikën 13 "kushtet komerciale", në fletë ngarkesën e CIM-it, shënohet shfrytëzuesi i transportit dhe numri rendor i trenit marshut.

Në rast se nuk plotësohen kushtet e parashikuara më sipër për tren marshut, ky tren nuk do të trajtohet si tren marshut, çmimet e transportit kalkulojnë si për tren të rëndomtë.

Çmimet e transportit për kontejnerë llogariten në bazë të tabelës tarifore për kontejnerë dhe atë:

TABELA TARIFORE PËR TRANSPORTIN E KONTEJNERVE NË TRAINKOS SH.A.

Tabela nr.3

| Relacioni | Lloji i kontejnerit | Çmimi për kontejner të plotë | Çmimi për kontejner të zbrazët | Vërejtje |
|---|---------------------|------------------------------|--------------------------------|----------|
| Hani i Elezit - Miradi dhe anasjelltas | 10' | 35.00 € | 15.00 € | |
| | 20' | 67.00 € | 29.00 € | |
| | 30' | 83.00 € | 35.00 € | |
| | 40' | 95.00 € | 35.00 € | |
| Leshak - Miradi dhe anasjelltas | 10' | 40.00 € | 20.00 € | |
| | 20' | 80.00 € | 40.00 € | |
| | 30' | 95.00 € | 45.00 € | |
| | 40' | 110.00 € | 50.00 € | |
| Hani Elezit-Mitrovicë dhe anasjelltas | 10' | 45.00 € | 20.00 € | |
| | 20' | 90.00 € | 40.00 € | |
| | 30' | 105.00 € | 45.00 € | |
| | 40' | 120.00 € | 50.00 € | |
| Leshak - Pejë dhe anasjelltas | 10' | 65.00 € | 25.00 € | |
| | 20' | 130.00 € | 50.00 € | |
| | 30' | 160.00 € | 60.00 € | |
| | 40' | 180.00 € | 70.00 € | |
| Hani Elezit - Ferizaj/Gurëz dhe anasjelltas | 10' | | | |
| | 20' | 50.00 € | 20.00 € | |
| | 30' | | | |
| | 40' | 65.00 € | 25.00 € | |
| Hani Elezit - Drenas dhe anasjelltas | 10' | | | |
| | 20' | 80.00 € | 40.00 € | |
| | 30' | | | |
| | 40' | 110.00 € | 50.00 € | |
| Hani Elezit - Pejë dhe anasjelltas | 10' | | | |
| | 20' | 115.00 € | 45.00 € | |
| | 30' | | | |
| | 40' | 160.00 € | 60.00 € | |
| Hani Elezit - Klinë dhe anasjelltas | 10' | | | |
| | 20' | 108.00 € | 40.00 € | |
| | 30' | | | |
| | 40' | 144.00 € | 60.00 € | |
| Hani Elezit - Xërxe dhe anasjelltas | 10' | | | |
| | 20' | 125.00 € | 50.00 € | |
| | 30' | | | |
| | 40' | 170.00 € | 70.00 € | |
| Hani Elezit - Lypjan dhe anasjelltas | 10' | | | |
| | 20' | 55.00 € | 25.00 € | |
| | 30' | | | |
| | 40' | 80.00 € | 30.00 € | |
| Hani Elezit - Kastriot dhe anasjelltas | 10' | | | |
| | 20' | 75.00 € | 35.00 € | |
| | 30' | | | |
| | 40' | 110.00 € | 40.00 € | |
| Hani Elezit - Vushtrri dhe anasjelltas | 10' | | | |
| | 20' | 100.00 € | 40.00 € | |
| | 30' | | | |
| | 40' | 140.00 € | 50.00 € | |
| Drenas - Mitrovicë dhe anasjelltas | 10' | | | |
| | 20' | 64.00 € | 26.00 € | |
| | 30' | | | |
| | 40' | | | |
| Miradi - Drenas dhe anasjelltas | 10' | 50.00 € | 20.00 € | |
| | 20' | | | |
| | 30' | 65.00 € | 25.00 € | |
| | 40' | | | |

| | | | | |
|----------------------------------|-----|----------|---------|--|
| Miradi - Pejë dhe anasjelltas | 10' | 100.00 € | 40.00 € | |
| | 20' | | | |
| | 30' | 140.00 € | 50.00 € | |
| | 40' | 50.00 € | 20.00 € | |

Vërejtje:

Nëse në vagon janë të ngarkuar 2 kontejner të kategorisë 10', çmimet e transportit llogariten si një kontejner i kategorisë 20';

Çmimet e mësipërme për transport të mallrave me kontejnerë janë pa TVSH.

Masa e ngarkuar në kontejner së bashku me masën e kontejnerit nuk guxon të mbikalojë shtypjen boshtore dhe masën e lejuar për ngarkim të vagonit. Nëse për transport përdoren kontejnerët më të gjërë dhe më të lartë se 2.44 m , çmimet e transportit për këtë lloj të kontejnerit kalkulohen sipas çmimeve baze të përcaktuara në tabelën tarifore për transportin e kontejnerëve duke paguar çmimin shtesë 20 € për kontejner të plote si dhe 10 € për kontejnerë të zbrazët.

Në mungesë të transportit të rregullt në vijat hekurudhore nga Fushë Kosova për në Drenas , Klinë, Xërxë, Pejë, Kastriot dhe Vushtri caktohet masa minimale e transportit të kontejnerëve: për kontejner 20FT masa minimale do të jetë 14 kontejnerë ndërsa për transportin e kontejnerëve 40 FT masa minimale do të jetë 8 kontejnerë, në rastet e transportit të mallrave në relacionet e përmendura më sipër, nëse gjatë ditës operon ndonjë tren ditor i transportit të udhëtarëve nuk do të zbatohen masat minimale të ngarkesave për kontejner.

4.8 Transporti i dërgesave të veçanta

Dërgesat të cilat tejkalojnë gabaritin ngarkues , shtypjen boshtore të lejuar, ose për metër gjatësi ose nuk i plotësojnë normat e parapara teknike , të cilat në transport paraqesin vështërsi të posaçme transportuesit për të cilën duhet të merren masa të veçanta teknike dhe mbrojtëse, pranohen në transport vetëm në bazë të kontratës së posaçme e lidhur në mes të transportuesit dhe shfrytëzuesit të transportit.

Me kontratë të posaçme caktohen detyrimet e shfrytëzuesit të transportit për ter rrugën e transportit, kushtet e transportit, rruga kaluese, përqindja e rritjes së çmimit të transportit si dhe shpenzimet tjera për shërbim.

Dërguesi i cili dëshiron të dorëzojë në transport dërgesën e posaçme duhet që paraprakisht të lajmëroi hekurudhën për caktimin e kushteve të transportit.

Kërkesën me shkrim duhet ta bën para se të filloi transporti dhe atë me Sa vijon:

- Në 10 dit për dërgesat e veçanta që transportohen në komunikacionin e brendshëm
- Në 30 dit për dërgesat që transportohen në komunikacionin ndërkombëtar

Krahas çmimit të kalkuluar për transport të rendomt për dërgesat vagonore , llogaritet edhe çmimi shtesë për dërgesë të posaçme.

Çmimi shtesë llogaritet për ter relacionin ashtu që çmimi i kalkuluar i transportit rritet për:

- **120%** Transporti i dërgesës së posaçme që nuk lejohen të transportohen natën por vetëm gjatë ditës , me përcjelljen e domosdoshme të organeve dhe ekspertëve profesional të hekurudhës nga lëmia e shërbimit teknik të vagonëve dhe të ndërtimtarisë.
- **60%** Kur duhet që trenit të zvogëlohet shpejtësia për arsye të dërgesa e tejkalon gabaritin në gjersi apo masën e lejuar për bosht respektivisht për metër gjatësi për çka është e nevojshme të parashihet numër ma i madh vozitjeve të ngadalësuara neper disa pika kritike në linjë (tunele, ura , lëshesa etj)

- Transporti vetëm ditën për shkak të kontrollit të domosdoshëm të linjës hekurudhore pas kalimit të dërgesës së posaçme e cila tejkalon peshën për bosht ose metër gjatësi.
- Përcjellja e domosdoshme e organeve profesionale të hekurudhës të shërbimit teknik të vagonëve dhe ndërtimtarie për dërgesën e cila nuk tejkalon gabaritin ngarkues por se është e domosdoshme përcjellja për shkak të natyrës së mallit për shkaqe sigurie.
- Transporti i lokomotivave të cilat nuk janë pronë e HK. Trainkos sh.a e cila transportohet në rrotat e veta në gjendje të ftohtë jashtë punë me përcjellje të cilën e siguron shfrytëzuesi i transportit e cila bartet me trena të rregullt me kufizim shpejtësie deri në 60 km/h.

Dërgesat e veçanta, transportohen në bazë të kërkesës dhe pëlqimit paraprak nga Trainkos Sh.A.

Çmimet e transportit kullohen në bazë të elementeve të definuara nga Trainkos Sh.A. me pëlqimin e dhënë për transport.

Neni 5 Kalkulimi – llogaritja e RIV-it

Kalkulimi – llogaritja e RIV-it për përdorimin e vagonëve nga Trainkos-i zbatohet për vagonët të cilët janë pronë e hekurudhave tjera.

Në bazë të marrëveshjes ndërmjet Trainkos Sh.A. dhe Hekurudhave të Maqedonisë, Trainkos Sh.A. obligohet që për përdorimin e vagonëve të Hekurudhave të Maqedonisë dhe hekurudhave të tjera

Trainkos Sh.A pagesat e RIV-it do të pranoj/kontrolloj/realizoj në baze të faturimit nga Hekurudhat Maqedone e cila është e bazuar në RIV 2000 .

Klienti – shfrytëzuesi i transportit është i obliguar që Trainkos-it ti ofroj dëshminë se nga pronari i vagonëve – Hekurudhës përkatëse është i liruar nga llogaritja e RIV – it, këtë dëshmi e dërgon pas nisjes së vagonit nga stacioni i nisjes (i plotë ose i zbrazët), për territorin e Kosovës në të cilin operon Trainkos-i, të cilën e dërgon përmes postës elektronike ose postës së rëndomtë. Lirimi nga llogaritja e RIV-it përfshin kohën e qëndrimit të vagonit prej momenti të hyrjes deri në momentin e shkarkimit vagonëve.

Për këtë arsye, Trainkos-i për përdorimin e këtyre vagonëve zbaton llogaritjen në shumën prej 15.50 Euro për vagonë 2 boshtor dhe 31.00 € për vagonë 4 boshtor, për 24 orë dhe atë për ose pas ndryshimit të RIV-it:

Trainkos Sh.A për përdorimin e këtyre vagonëve zbaton llogaritjen në shumën prej 0.64 Euro/Ore për vagonë 2 boshtor si dhe 1.29 Euro/Ore vagonë 4 boshtor për:

- a) Import – prej momentit të hyrjes së vagonëve në stacionet kufitare të Trainkos-it deri në momentin e shkarkimit
- b) Eksport - prej momentit të hyrjes së vagonëve në stacionet kufitare dhe vendosja për ngarkimi deri në momentin e zhdoganimit të tyre; dhe
- c) Nëse vagonët mbesin për kohë më të gjatë se 10 ditë për kalkulimin në hekurudhë – llogaritjen e RIV-it do të zbatohet çmimi sipas Rregullores RIV-2000, me plotësimet dhe ndryshimet e vitit 2004 sipas tabelës së mëposhtme :

Tabela nr. 4

| Çmimi për grupen e vagonëve | Orët (euro/orë) | | |
|-----------------------------|------------------|-------------------|-------------|
| | Seria e vagonëve | Prej 240 -720 orë | Mbi 720 orë |
| Vagonët 2- boshtorë | | | |
| 101 | E | 0.59 | 1.04 |
| | G | 0.59 | 1.04 |
| | GB | 0.59 | 1.04 |
| | K | 0.59 | 1.04 |
| 102 | LG | 1.00 | 1.54 |
| | KG | 1.00 | 1.54 |
| | LD | 1.00 | 1.54 |
| 103 | F | 0.77 | 1.36 |
| | HBI | 0.77 | 1.36 |
| | TD | 0.77 | 1.36 |
| | T | 0.77 | 1.36 |
| 104 | HBIL | 1.20 | 1.84 |
| | HBBI | 1.20 | 1.84 |
| 105 | U | 1.57 | 2.42 |
| | LA | 1.57 | 2.42 |
| Vagonët 4 - boshtorë | | | |
| 201 | GA | 1.07 | 1.86 |
| | GAB | 1.07 | 1.86 |
| 202 | EA | 1.11 | 1.96 |
| | RMM | 1.11 | 1.96 |
| | R | 1.11 | 1.96 |
| | RE | 1.11 | 1.96 |
| 203 | RG | 1.52 | 2.33 |
| | SG | 1.52 | 2.33 |
| | SDG | 1.52 | 2.33 |
| 204 | SH | 1.50 | 2.29 |
| | SHI | 1.50 | 2.29 |
| | TA | 1.50 | 2.29 |
| | TAD | 1.50 | 2.29 |
| | FA | 1.50 | 2.29 |
| | ZA | 1.50 | 2.29 |
| 205 | S | 1.47 | 2.25 |
| | RI | 1.47 | 2.25 |
| 206 | HABIL | 2.02 | 3.11 |
| | SA | 2.02 | 3.11 |
| | SGG | 2.02 | 3.11 |

Ky kalkulim – llogaritje zbatohet për çdo vagon të subjektit afarist, përveç nëse Hekurudhat e Maqedonisë e kanë konfirmuar lirimin për kohë të caktuar ose të tërësishëm dhe nëse vagonët janë të shfrytëzuesit të transportit (Privat) ose të marr me qira.

Subjektet afariste nga obligimet e RIV-it lirohet vetëm nëse vagonët kanë qëndruar më gjatë për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme.

Departamenti i operimeve ne rastet e jashtëzakonshme ne kontestet doganore fatkeqësitë e tjera elementare i propozon drejt Kryeshefit Ekzekutiv për lirimin nga pagesat e shkaktuara dhe konfirmimin për lirim e bënë Kryeshefi Ekzekutiv i Trainkos Sh.A.

Neni 6
Pagesat shtesat

1. Pagesat shtesë për vendosjen e vagonëve në vijat hekurudhore të industrisë

Duke marr parasysh se binaret industrial dallojnë , varësisht nga vendi i degëzimit - nga stacioni ose segmenti i vijës së hapur hekurudhore dhe gjatësisë së tyre, përkohësisht caktohen këto pagesa shtesë për vendosjen e vagonëve për ngarkim/shkarkim në vijat hekurudhore të binareve industrial:

Tabela nr.5
TABELA TARIFORE PËR PAGESAT SHITESË

| Stacioni | Pronari i binarëve industrial | Shfrytëzuesi i binarit industrial | Çmimi për vendosje | KM | Vërejtje |
|---------------|-------------------------------|-----------------------------------|--------------------|----|----------|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| Miradi | Standard Plin | Standard Plin | 12.00 € | | |
| | Infrakos Sh.A. | Bis Oil Team | 7.00 € | | |
| | Patroni Kompani | Patroni Kompani | 10.00 € | | |
| | Petrol Kompani | Petrol Kompani | 7.00 € | | |
| | Al Petrol | Al Petrol | 10.00 € | | |
| | Standard Benz - Preoce | EX-Fis | 20.00 € | | |
| Fushë Kosovë | Fam Gas | Fam Gas | 20.00 € | | |
| | Silloi Fushë Kosovë | Silloi F.K. | 12.00 € | | |
| Bablak | Hib Petrol | Hib Petrol | 10.00 € | | |
| Lipjan | Fabrika e letrës | Sh.P.K "Beta" | 10.00 € | | |
| Ferizaj | Fabrika e gypave | | 20.00 € | | |
| | Fabrika e vajit | Alkoni | 20.00 € | | |
| | Depo bujqësore | | | | |
| Kaçanik | Fabrika e Gëlqeres | New Lepenci | 12.00 € | | |
| Hani i Elezit | Fabrika e cementit | | 10.00 € | | |
| Drenas | NewCo Ferronikel | Ferronikel | 25.00 € | | |
| Klinë | Silloi | | 20.00 € | | |
| Pejë | Fabrika e birrës | | 20.00 € | | |
| | Fabrika e sheqerit | | 20.00 € | | |
| | Fabrika e autopjesëve | | 20.00 € | | |
| | Kombinati i drurit | | | | |
| Xërxe | Silloi | Silloi | 10.00 € | | |
| Mitrovicë | Trepça-Fabrika e baterive | Trepça-Fabrika e baterive | 20.00 € | | |
| Vushtrri | Stella-Llamkos | Stella-Llamkos | 12.00 € | | |
| Kastriot | Binari i KEK-ut | | 12.00 € | | |
| | Binari I KEK-ut Kosova B | | 20.00 € | | |
| Bardhosh | INA-Bardhosh | | 10.00 € | | |
| Zveçan | Hek- Vallaç | | 20.00 € | | |

Vërejtje: Çmimi për vagon kalkulohet në Euro

Çmimet e mësipërme për vendosjen e vagonëve ne binare industrial janë me TVSH .

Për vendosjen e vagonëve në ngarkim/shkarkim në vijat hekurudhore të stacionit nuk zbatohet pagesa shtesë, përveç në rastet kur klienti parashtron kërkesa të veçanta për vendosjen e vagonëve në vend të caktuar, atëherë zbatohet pagesa shtesë prej 5.00 € për vagon.

2. Pagesat shtesë për matjen e vagonëve

Matja e vagonëve në peshoren e Infrakos-it realizohet në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të transportit, kërkesë së Doganave të Kosovës, Policisë së Kosovës, organeve të tjera dhe në bazë të dyshimit nga ana e Trainkos-it.

- Për matjen e vagonëve të plotë – zbrazët, me kërkesë të shfrytëzuesit të transportit, kalkulohet pagesa shtesë prej 20.00 € për vagon;
- Gjatë matjes së vagonëve të zbrazët (taririm), me kërkesë të shfrytëzuesit të transportit, nëse konstatohet dallimi ndërmjet masës së shënuar në vagonë dhe masës së konstatuar deri në $\pm 2\%$ atëherë nuk do të llogaritet pagesa shtesë për matje (taririm).
- Për matjen e vagonëve me kërkesën e Doganave të Kosovës ose të Policisë së Kosovës për shërbimin e kërkuar, matja e vagonëve nuk faturohen.

Neni 7

Beneficionet – tarifore

Që Trainkos-i të jetë më atraktiv, më i leverdishëm dhe më konkurrentë në tregun e transportit, klientëve – shfrytëzuesve të shërbimeve të transportit hekurudhor, Trainkos Sh.A ofron këto beneficione tarifore:

- a) Për transportin e mallrave sipas marrëveshjes, beneficionet tarifore varën nga lloji i marrëveshjes së lidhur për një vit kalendarik. Për transport sipas marrëveshjes Trainkos Sh.A ofron zbritjen e çmimit tarifor të cilat varen nga sasia e mallrave të transportuar gjatë një viti kalendarik, nëse klienti – subjekti afarist transportin e deklaruar e realizon sipas marrëveshjes së kontraktuar dhe atë si në tabelën e mëposhtme :

Tabela nr.6

Tabela tarifore e beneficioneve për klientët me deklarim të sasisë së transportit

| Prej – Deri | Deklarim – Realizim |
|-----------------------|---------------------|
| 10 001 – 50 000 t | 3 % |
| 50 001 t - 100 000 t | 5 % |
| 100 001 t - 200 000 t | 7 % |
| Mbi 200 001 t | 10 % |

Ndërsa për mos realizimin e sasisë së deklaruar do të aplikohet përqindja në baze të tabelës së mësipërme sipas neto toneve të realizuar.

b) Klienti – subjekt afarist, beneficionet e theksuara më sipër mund të realizoi pas përfundimit të vitit kalendarik për të cilin është lidh kontrata, nëse Sektori i Financave të Trainkos Sh.A, konstaton se transporti është realizuar si pas marrëveshjes. Beneficionet, Trainkos-i do të paguaj deri në fund të muajit Mars të viti në vijim.

Vërejtje: Beneficionet e theksuara më sipër, klienti – subjekti afarist, sasinë e deklaruar duhet ta realizoi deri më përfundimin e vitit kalendarik, pas vitit kalendarik nëse konstatohet se sasinë e transportit të deklaruar sipas marrëveshjes e ka realizuar brenda vitit kalendarik, pagesa e beneficioneve realizohet sipas tabelës së mësipërme

Tabela nr.7

(Tabela tarifore e beneficioneve për klientët me deklarim te sasisë se transportit).

I. Tabela tarifore e beneficioneve për klientët e rendomë

| Prej – Deri | Realizim |
|----------------------|-----------------|
| 10 000 t – 50 000 t | 2 % |
| 50 001 t - 100 000 t | 3 % |
| Mbi 100 001 t | 5 % |

Vërejtjet: Zbritjet tarifore të theksuara më sipër, klienti – subjekti afarist mund ti realizoi pas përfundimit të vitit kalendarik, nëse nga ana e Trainkos-it konstatohet se klienti – subjekti afarist e ka realizuar sasinë e transportit sipas tabelës Nr 2 (tabela tarifore e beneficioneve për klientët e rëndomtë).

Te gjithë klientët/partneret te cilët kane kontrate te veçante te transportit me te cilën kane përfituar zbritje te tarifave te rregullta per ate sasi te transportit nuk do te perfitojne beneficinet e mësipërme.

Këto zbritje, Trainkos-i do ti paguaj deri në fund të muajit Mars të vitit në vijim.

Neni 8

Zbritja e çmimeve tarifore

Me qëllim të shtimit te klientëve të ri, Kryeshefi Ekzekutiv me vendim të menaxhmentit mund të ofroj zbritje deri në 20% të çmimit të rregullt. Tek klientët që bartin sasi të mëdha transporti ose vlerësohen arsye të tjera më qellim që të jemi sa më atraktiv në oferta dhe kur është në interes dhe përfitim të Trainkos Sh.A mund t'i propozohet Bordit të Drejtoreve të Trainkos Sh.A . Ofrimi i zbritjeve me te larta se 20% ose lirimi i ndonjë shërbimi tjetër qe ofron Trainkos Sh.A Ky organ mund te lejoj zbritjen e çmimeve te rregullta tarifore me pagesën për shërbime te tjera te cilat janë te parashikuara ne këtë rregullore;

Neni 9

Kufizimet

Në mungesë të trenave të rregullt për transportin e mallrave në vijat hekurudhore Fushë Kosovë – Xërxë, Fushë Kosovë – Pejë, Fushë Kosovë – Leshak, për transport caktohet masa minimale e dërgesave prej 250 neto ton.

Për transportin e mallrave në relacionet e përmendura më sipër, nëse qarkullon ndonjë tren ditor (tren transportues ose tren i udhëtareve me garniturë klasike), nuk do të zbatohet masa minimale e ngarkesës për 250 neto ton, përveç në rastet kur transportohen mallrat të cilat bëjnë pjesë në kategorinë e mallrave me shkallën e rrezikut të caktuar (të cilat janë të theksuara në rregulloren RID).

Nëse klienti pranon faturimin e transportit te caktuar në masën minimale prej 250 neto ton, Trainkos Sh.A do të pranojnë dhe transportojnë edhe ato dërgesa të cilat do të transportohen më trenat të veçantë.

Neni 10
Pagesa e borxheve

Sektori i financave i Trainkos-it, në baza 15 ditore, duke u bazuar në obligimet e kontratës – marrëveshjes së nënshkruara nga palët përcjell , kontrollon dhe raporton për borxhin e klientëve – subjekteve afariste. Sektori i financave i Trainkos Sh.A varësisht nga marrëdhëniet debitorë – kreditore përgatit vërejtjet , pasqyrën financiare të kartelës së klientit të cilën ia dërgon përmes postes elektronike dhe e njofton për borxhin ndaj Trainkos-it. Sektori i financave për mos kryerjen e pagesave nga ana e klientit si pas afateve të parashikuara me kontratë – marrëveshje, obligohet të llogarit ndëshkimet për vonesat e konstatuara dhe për këtë e njofton klientin.

Sektori i financave te Trainkos Sha bënë barazimin financiar të klientëve dhe varësisht nga gjendja e konstatuar në fund të vitit detyrimisht përgatit dhe raporton për gjendjet – saldot.

Trainkos Sh.A, mbajnë të drejtën e ndryshimit të kontratës për transportin e mallrave dhe mënyrën e pagesës së borxheve për klientët të cilët janë identifikuar si borxhli ndaj Trainkos-it për vitin e kaluar.

Në rast të vonesave të shkaktuara në pagesën e obligimeve kontraktuale, me ç`rast garancioni bakar nuk e mbulon vlerën e borxhit, të aplikohet penalet prej 0.05 % në baza ditore.

Neni 11.
Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të Trainkos sh.a dhe fillon të zbatohet nga data 01.01.2017

Me hyrjen në fuqi e kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja e mëparshme .

Me dispozitat e kësaj rregullore duhet të njoftohen të gjithë departamentet përkatëse të Trainkos Sh.A.

Tabela nr. 8 . Shkurtesat

| | |
|-----------------|---|
| Trainkos | Hekurudhat e Kosovës -Trainkos Sh.A. |
| RIV | Rregullore për përdorimin e përbashkët te vagonëve të mallrave komunikacionin ndërkombëtar |
| CIT | Komiteti ndërkombëtar i hekurudhave |
| CIM | Flet ngarkesa (kontrata për transportin e mallrave) në komunikacionin ndërkombëtar |
| Vagon Shtetëror | Vagonët që janë pronë e Hekurudhave Shtetërore-Publike Vagonët dy boshtor identifikohen me numrin 21 Vagonët katër boshtor identifikohen me numrin 31 |
| Vagon Privat | Vagonë privat apo të marrua me qera Identifikohen me shkronjën P ose me numrin 33 apo 35 |
| TEA | Tarifat , Evropa , Azia |

Sadik Kryeziu


Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve



Telemetri për transportin e mallrave në Trainkos Sh.A.

Shtojca I e Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve për kontratat , kushtet e transportit dhe zbatimin e pagesave nga transporti i realizuar deri në hartimin dhe aprovimin e tarifave të Trainkos Sh.A.

| Nga stacioni Hani Elezit kufi | Gjerë në stacionin | Nga stacioni Leshak kufiri |
|-------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| KM | | KM |
| 0 | ----- Hani Elezit kufiri----- | 165 |
| 2 | ----- Hani Elezit----- | 163 |
| 15 | ----- Kaçanik----- | 150 |
| 26 | ----- Gurzë----- | 139 |
| 35 | ----- Ferizaj----- | 131 |
| 46 | ----- Bablak----- | 119 |
| 57 | ----- Lypjan----- | 108 |
| 69 | ----- Miradi----- | 96 |
| 72 | ----- Fushë Kosovë----- | 93 |
| 78 | ----- Kastriot----- | 87 |
| 85 | ----- Prëlluzhë----- | 80 |
| 99 | ----- Vushtrri----- | 66 |
| 109 | ----- Mitrovicë----- | 56 |
| 114 | ----- Zveqan ----- | 51 |
| 134 | ----- Sllatinë ----- | 31 |
| 145 | ----- Leposaviq ----- | 20 |
| 156 | ----- Leshak ----- | 9 |
| 163 | ----- Jarinë v.q. ----- | 2 |
| 165 | ----- Kufiri (Leshak----- | 0 |

Tabela nr.9 Relacioni: Hani Elezit – Fushë Kosovë – Leshak

Tabela nr.10 Relacioni: Bardhosh - Fushë Kosovë – Pejë

| Nga stacioni Bardhosh | GJERË NË STACIONIN | Nga stacioni Pejë |
|-----------------------|--------------------|-------------------|
| KM | | KM |
| 00 | Bardhosh ----- | 102 |
| 08 | Prishtinë ----- | 94 |
| 16 | F. Kosovë ----- | 86 |
| 22 | Bardh ----- | 80 |
| 41 | Drenas ----- | 61 |
| 63 | Ujmirë ----- | 39 |
| 75 | Klinë ----- | 28 |
| 102 | Pejë ----- | 00 |

Tabela nr.11 Relacioni: Klinë – Prizren – Klinë

| Nga stacioni Klinë | GJERË NË STACIONIN | Nga stacioni Prizren |
|--------------------|--------------------|----------------------|
| KM | | KM |
| 00 | Klinë ----- | 64 |
| 09 | Volljakë ----- | 55 |
| 39 | Xërxe ----- | 25 |
| 50 | Bajram Curr ----- | 14 |
| 64 | Prizren ----- | 00 |

Aprovuar më

30.12.2016

Sadik Kryeziu

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Fushë Kosovë
Dhjetor 2016